



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2020:110967

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05728748

C.nr. 863/2020

GJYKATA THEMELORE NË G. - DEGA NË V., Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë kontestimore e shkallës së parë, sipas gjyqtarit Raif Fazliu, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit E.Z., nga V.a, rr.”28 Nëntori”, të cilin me autorizim e përfaqëson E.A.avokat në Prishtinë, kundër të paditurve G.J. nga J., Republika e Sërbisë, të cilën e përfaqëson e paditura T.S., e T.Z., të cilët i përfaqëson i padituri T.B., që të gjithë nga K. dhe S.D., nga K., të cilën me autorizim e përfaqëson F.Y., avokat ne G. dhe e paditura P.Z., nga Smedereva, Republika e Serbisë, te cilën po ashtu me autorizim e përfaqëson I.S., nga K., në çështjen juridike vërtetimi i pronësisë në bashkëpronësi, vlera e kontestit 20,000 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik me 19.03.2024, ndërsa pas pranimit të fjalës përfundimtare mbi aspektet juridike dhe faktike të palëve të dorëzuara me shkrim me 20.04.2024, ndërsa me datë 16.05.2024, përpilon këtë:

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit E.Z. nga V.a, **VËRTETOHET** se paditësi mbi bazën e kontratës së shitblerjes është pronar i vetëm i paluajtshmërisë, e cila përbëhet nga njësia kadastrale nr.P-73701026-01041-1, me sipërfaqe prej 7664 m², në vendin e quajtur “Brestovi Utrina” në Zonën Kadastrale KK., me këto përmasa dhe përkufizime;

Në anën Lindore kufizohet me ngastrën nr.1780-0, përkatësisht me rrugën publike KK.-V. në gjatësi prej 145.94 m, në anën Jugore me ngastrën nr.1041-2 në gjatësi prej 66.70 m. në anën Perëndimore kufizohet me ngastrën kadastrale nr.1042-0 në gjatësi prej 79.11 m, ndërsa në anën Veri-Perëndimore kufizohet me ngastrën nr.1779-0, përkatësisht me rrugën regionale Ferizaj-G. me gjatësi prej 97.92 m.

Përmasat dhe përkufizimet bazohen në ekspertizën e ekspertit gjeodet dhe skicën gjeodezike të Feat Shaqiri, të datës 28.06.2022.

II. Të paditurit G.J., T.S., T.Z., T.B., S.D. dhe P.Z., do të Lejojnë dhe Durojnë paditësin E.Z., që paluajtshmërinë nga pika I e aktgjykimit ta regjistroj në regjistrat kadastrale të Komunës së K.t, në pronësi individuale të paditësit, ndërsa bazë për regjistrim do të jetë ky aktgjykim, i cili do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së tij.

- Masa e përkohshme siguroese e caktuar me Aktvendimin C.nr.19/13, me datë 30.01.2013, mbetet edhe më tej në fuqi për ngastrën nr.1041-1, me 7664 m² ZK KK., deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.

III.Detyrohen të paditurit G.J., T.S., T.Z., T.B., S.D. dhe P.Z., që solidarisht paditësit E.Z. t`ia kompensojnë shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 5,238 euro, 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Shuma tjetër e kërkuar për shpenzime nga paditësi prej 1,858 euro, refuzohet si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Paditësi E.Z. nga V.a, kishte ushtruar padi me propozim për lejimin dhe caktimin e masës së përkohshme, respektivisht për ndalimin e tjetërsimit në persona të tretë, të ngastrave kadastrale të evidentuara në certifikatën e pronës nr. 69, e datës 28.12.2012, Zona Kadastrale (ZK) KK., e ku ishin dhjetë (10) ngastra kadastrale dhe atë ngastrat nr; 426-0, nr.436-0, nr.1041-1, nr.1041-2, nr.1041-3, nr.1041-4, nr.1181-0, nr.1221-0, nr.1739-0 dhe 1740-0, ndërsa paditësi ishte bashkëpronarë me 672/1008, apo të 4/7-ve, në pjesët ideale të këtyre ngastrave.

Gjykata kishte vendosur për caktimin e masës së përkohshme, duke e lejuar atë në dhjetë ngastrat e evidentuara në certifikatën e pronës nr.69, ZK KK., përfshirë edhe tani ngastrën kontestuese nr.1041-1, ZK KK..

Paditësi përmes parashtrësës që kishte dorëzuar i autorizuari i tij H.J., me datë 27.11.2013, kishte bërë precizimin e padisë, duke e konsideruar si padi për vërtetimin e pronësisë dhe ndarjen e bashkëpronësisë, për ngastrën kadastrale nr.1041-1, me sipërfaqe prej 7664 m² dhe një pjesë të ngastres nr.1041-2, ZK KK..

Gjykata të paditurve ju kishte dërguar në përgjigje padinë e parë dhe precizimin e saj.

Nga të gjithë të paditurit, përgjigje i vetmi kishte dhënë përfaqësuesi i të paditurës S.D., avokati F.Y.. Ai përmes përgjigjes kishte thënë se me rastin e shitblerjes se ngastres 1041-1, kjo ngastër nuk kishte qenë e ndarë fizikisht në terren, sepse bashkëpronarët për ndarje kurrë nuk kishin arritur marrëveshje. Po ashtu, gjatë shitblerjes nga blerësi nga paditësi E.Z., nga shitësja Z. P., sipas mendimit të këtij avokati, ajo kishte pasur fëmijë të mitur, ashtu që ajo nuk ka mundur t`ia shet atij pjesën e vet deri sa të arrijnë moshën madhore. Për këtë kemi kërkuar që kjo kontratë të anulohet. Andaj, kishte propozuar përmes përgjigjes në padi që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

Në seancën përgatitore me datë 05.03.2014, përfaqësuesi i paditësit E.Z., tani avokati H.J., kishte propozuar të dëgjohet vet paditësi në cilësinë e palës paditëse, por edhe gjykata ti administroj dhe vlerësoj deklaratat me shkrim të dëshmitarëve Gjorgje Tomiq, N.S., M. P. dhe Z. P.. Mbi bazën e argumenteve dhe këtyre provave gjykata t`ia njeh të drejten e pronësisë paditësit dhe të bëjë ndarjen fizike të bashkëpronësisë në llogari të paditësit.

Ky përfaqësues kishte tërhequr kërkesat për ngastrat tjera, duke e drejtuar dhe specifikuar kërkesën vetëm sa i përket ngastrës kadastrale nr.1041-1, me sipërfaqe prej 7664 m².

I padituri B.T., i cili ishte prezent, nuk e kishte kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit.

Kurse i padituri X.T., kishte deklaruar se si babai i paditësit S.Z., kishte ardhur tek ky i paditur, i cili e kishte lejuar që bashkëpronarja Z. P. t`ia shet këtë ngastër këtij personi, sepse i padituri X.T. nuk kishte shprehur dëshirë as ta blej ngastrën, as ta pengoj që t`ia shet kujdoçoftë, duke i thënë që mund ta blen edhe familja e paditësit. S. ka biseduar me Zagorken, e cila jeton në Shkup dhe M. P., që jetonte në Sërbi. Pasi i kishin kontraktuar pjesët e tyre, vëllau i paditësit H.Z., me

sytë e mi e kam parë në “Bit Pazar” të Shkupit, kur ai Z. ia kishte dorëzuar në dorë 34,000 euro, ndërsa M.s po ashtu paratë ia kishte dhënë S., por nuk e di sa para i kishte dhënë. Mendoj se ngastra bazë 1041, duhet të ishte ndarë në pesë (5) pjesë apo hise të barabarta, secilit nga 26

ari duke i përmendur trashëgimtarët: Z., M.n, D.S., P. Z. dhe X.T.in, e cila në total pa u nda kishte sipërfaqen prej 1 hektar e 34 ari.

Ky i paditur kishte theksuar se paditësi kishte blerë hiset e Zagorkes dhe M.s duke e specifikuar se kishte blerë sipërfaqen që shtrihet nga udhëkryqi i rrugës regjionale KK.-Ferizaj e KK.-V..

I autorizuari i të paditurës S.D., avokati F.Y. kishte propozuar që nëse paditësi nuk propozon bashkimin e lëndëve të evidentuar me nr.C.nr.105/2012, në të cilën rolin e paditësit e kanë disa nga tani të paditurit, kurse i paditur është tani paditësi E.Z. dhe P.M., me lëndën e tanishme C.nr.19/2013, ne do ta bëjmë një propozim të tillë. Ai deklarantën e vetë e kishte bazuar në përgjigjen në padi, duke shtuar se trashëgimtar i vetëm në pasurinë e të ndjerëve L.S., C.S.dhe S. S., me aktvendimin e trashëgimisë ishte shpallur P. M., e ai mund ta disponoj vetëm pasurinë e babait të tij. Edhe Z. P., trashëgimtare e pasurisë së bashkëshortit Antanas S., nuk ka mundur ta shet pasurinë e fëmijve të saj të mitur, për këtë arsye kontrata duhet shpallur nule. Ai më tej kishte shtuar se nuk është e vërtetë se kjo ngastër në terren është parcelizuar dhe nuk ekziston kurrfarë kufiri mes këtyre ngastrave. Po të ishte ndarë, pëlqimi do të nevojitej i gjithë bashkëpronarëve.

Në seancën e radhës me 08.04.2014, të paditurve P.M. dhe G.J., të cilëve nuk iu dihej adresa, me propozimin e përfaqësuesit të paditësit, gjykata kishte vendosur t'i caktoj një përfaqësues të përkohshëm, të cilëve i kishte caktuar avokaten Sadbere Maliqin.

Kurse në seancën e datës 07.05.2014, i autorizuari i paditësit av. H.J.kishte sqaruar faktin se klienti i tij paditësi E.Z., para se ta kontrakttoj sipërfaqen kontestuese me të paditurit, ai ishte dakorduar me ata edhe për pozitën fizike të ngastrës që e kishte blerë, natyrisht edhe me pëlqimin e bashkëpronarëve tjerë. Për këtë arsye paditësi e kishte ndarë dhe parcelizuar edhe në vendin e ngjarjes pjesën e tij ideale, duke e ndarë edhe në terren ngastrën me numër të ri si ngastër nr.1041-1, me sipërfaqe prej 7664 m², të cilën ndarje edhe e kishte regjistruar në operatin kadastral në ZKK KK.. Pas këtij parcelizimi ishin krijuar edhe ngastra tjera, duke u ndarë edhe tri nëndarje të reja. Andaj, paditësi ishte bashkëpronarë i ngastres 1041, me 672/1008, të pjesës ideale, apo më thjesht bashkëpronar në 4/7. Për këtë paditësi posedon tri kontrata mbi shitblerjen e pasurisë së paluajtshme ndërmjet tij si blerës dhe shitësve P. M., Z. P. dhe Z. P. e A. P., kontrata këto të vërtetuara në Gjykatën Komunale të V.së dhe të ekzekutuara në zyrën kadastrale. Përveç kontratave paditësi ka deponuar në gjykatë edhe deklaratat me shkrim të vërtetuara në gjykatë të: Gjorgje Tomiq, N.S., M. P. dhe Z. P., të gjitha në harmoni me kërkesën e paditësit.

I autorizuari i të paditurës S.D., av. F.I., kishte insistuar të bëhej bashkimi i lëndës që tani shqyrtohej, me lëndën të evidentuar me shifren C.nr.105/2012. Ai kishte shtuar se i padituri P. M. nuk ka mundur të shet me tepër pasuri, se sa ka mundur të jetë trashëgimtar. Ai përveç pjesës së babait të tij .it, nuk ka mundur t'i trashëgoj edhe hiset e xhaxhallarëve S.S. dhe S.C.. Këtë e dëshmon Aktvendimi T.nr.64/2010, i datës 07.06.2010.

I autorizuari i të paditurës P. Z., avokati F.B., e kishte përkrahur propozimin për bashkimin e lëndëve.

Edhe përfaqësuesi i paditësit H.J., ishte pajtuar me propozimin për bashkimin e lëndëve, andaj gjykata kishte vendosur për bashkimin e lëndëve, duke unifikuar lëndet me shenjat C.nr.19/2013 dhe 105/2012, në lëndë unike me shenjen C.nr.105/2012.

Në seancën e radhës me datë 28.05.2014, sipas lëndës 105/2012, paditës ishin V.G., S.D., P. Z., ndërsa të paditur ishin P. M., E.Z., ndërsa baza juridike e padisë ishte vërtetimi i drejtes se pronësisë në bazë të trashëgimisë dhe anulimi i kontratave mbi shitblerjen e paluajtshmërisë.

Përkundër faktit që gjykata kishte vendosur t'i bashkoj lëndët, për shkak të parimit të ekonomizimit dhe sigurisë së vendosjes së këtyre çështjeve, më vonë në seancën gjyqësore të datës 27.01.2015, gjykata e detyruar, kishte vendosur ta konsideroj të tërhequr padinë e paditëseve V.G., S.D. dhe P. Z., për shkak se këto paditëse sipas lëndës C.nr.105/12, nuk kishin kryer obligimet ligjore monetare, ndaj përfaqësueses së përkohshme, duke tejkaluar vonesën prej 20 ditësh. Andaj, kishte filluar ta shqyrtoj vetëm lëndën sipas padisë C.nr.19/2013.

Gjykata kishte shqyrtuar të bashkuara lëndët në tetë seanca (duke llogaritur edhe seancën e terrenit), por me qenëse lënda-padia e konsideruar e tërhequr C.nr.105/2015, sipas ankesave gjendej në Gjykatën e Apelit të Kosovës, ishte trajtuar vetëm lënda C.nr.19/2013.

Në seancën e datës 11.07.2014, gjykata kishte dëgjuar dëshmitarët si S.Z., i propozuar nga paditesi E.Z., i cili kishte sqaruar se si ishin kontraktuar hiset e tokës të blera nga M. dhe Z..

Të autorizuarit të paditurës S.D., av. F.Y.t, dëshmitari i kishte përgjigjur se hiset e pronarëve të tjerë ishin të ndara me disa megja të vogla mes vete, por pasi që ishin të papunuara, me veshtirësi vëreheshin megjat.

Kurse i autorizuari i të paditues P. Z., av. F.B., kishte pyetur dëshmitarin se M. i kujt ishte, a kishte motër apo vëlla, përgjigja ishte nuk me kujtohet dhe se kishte deklaruar, po i kam pyetur hiseniket e tjerë kur i kam ble këto hise.

Me 08.09.2014, avokatet F.Y. dhe F.B. kishin dorëzuar në gjykatë një parashtrësë përmes se cilës kishin propozuar që të dilet në vendin e ngjarjes, duke caktuar paraprakisht një ekspert gjeodet.

Në seancën e datës 09.10.2014, gjykata ka vendosur të dal në vendngjarje, ku me 31.10.2014 s`bashku me ekspertin gjeodet ishin në vendngjarje. Në vendngjarje gjykata kishte vërejtur dhe konstatuar se ngastra nr.1041-1, por edhe ngastrat tjera të ndara nga kjo ngaster, kishin qenë në gjendje të pa pashfrytëzuara, po thuaj se nuk vërehej vija ndarëse mes ngastres nr.1041-1 dhe 1041-2, edhe pse në afërsi të rrugës së asfaltuar KK.-V., respektivisht në pjesën juglindore në kufi të këtyre dy ngastrave, gjendej një dru në formë hunji, i ngulitur në tokë, të cilin e kishte ngulitur paditësi E.Z. para 5-6 viteve, në prezencën e V., M., P.M.s, N.S.it dhe Tomiq Gjorgjes. Gjithashtu në anën perëndimore në mes të ngastrave 1041-1 dhe 1041-2, ishte mbjell një pemë e llojit kajsii dhe një guri i vogël, e sipas ekspertit gjeodet ky guri vërtetonte vijën kufitare mes ngastrave 1041-1 dhe 1041-2.

Edhe eksperti gjeodet në ekspertizën e datës 31.10.2014, në fund të përshkrimit të ekspertizës kishte vërtetuar se nga matjet dhe piketimet e ngastrave kadastrale nr.1041-1 dhe 1041-2, kishte rezultuar se pikat e caktuara ishin të shënjzuar në terren me rastin e ndarjes fizike të tyre.

Në këtë seancë av. F.Y. kishte sjell një certificate të vdekjes, me të cilën ishte konstatuar se i padituri P. M., kishte vdekur, me 11.12.2012, ku gjykata ndaj këtij të padituri kishte ndërprerë procedurën. Pas kësaj rrethane përfaqësuesja e përkohshme kishte vazhduar ta përfaqësoj vetëm të paditurën G.J..

Dhe përkundër detyrimeve ligjore, por edhe me aktvendimin procedural të seancës së datës 23.12.2014, pala e paditëse-e kundërpaditur nuk i kishte kryer obligimet monetare ndaj përfaqësueses së përkohshme. Gjykata përveç urdhërit për pagesë, ia kishte bërë me dije edhe pasojën, por pa kurrfar arsye nuk ishte përmbushur obligimi ndaj përfaqësueses së përkohshme, e cila kishte kërcënuar se nuk mund ta vazhdoj përfaqësimin, sepse 4-5 seanca më herët vazhdimisht kishte njoftuar gjykatën se pagesat nuk po iu bëhen. Në këtë seancë gjykata kishte vendosur ta konsideroj të tërhequr padinë e paditësve, të evidentuar me shenjën C.nr.105/2012, andaj edhe kishte revokuar aktvendimin procedural të datës 07.05.2014, kur kishte bashkuar

lëndët, ndërsa tani kishte vendosur të vazhdoj me shqyrtimin e vetëm të lëndës C.nr.19/2013, pra duke i veçuar ato.

Me datën 25.02.2015, av. F.B., përmes parashtresës me shkrim kishte njoftuar gjykatën se e revokon autorizimin e dhënë nga e paditura P. Z., duke njoftuar gjykatën se nuk do të marr pjesë në seancën e caktuar me 16.03.2015.

Por në seancën e datës 30.04.2015, përfaqësuesi i të paditurës S.D., avokati F.Y., kishte kërkuar dhe insistuar të vazhdohet me shqyrtimin në të njëjten kohë edhe të lëndës C.nr.105/2012.

Por gjykata ia kishte rikujtuar këtij përfaqësuesi se s`mund të vazhdohet shqyrtimi për lëndën C.nr.105/12, nga se fizikisht kjo lëndë gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, sipas ankesës së palës që kërkon shqyrtimin e saj.

Ndërsa av. F.B., prap kishte vazhduar ta përfaqësoj të paditurën P. Z., përkundër revokimit të autorizimit nga seancë e kaluar, i cili po ashtu kishte vendosur të vazhdoj me përfaqësimin.

Në seancën e fundit të shqyrtimit kryesor përfaqësuesi i paditësit Esat Zeqir, juristi H.J.kishte deklaruar: se mbetet pranë precizimit të kërkesëpadisë, duke i propozuar gjykatës që paditësit t`ia njeh pronësinë ekskluzive në ngastrën kadastrale 1041-1, me 7664 m², jo si bashkëpronarë, por si pronar ekskluziv me 1/1, të kësaj ngastre, mbi bazën e shitblerjes.

Gjykata përmes Aktgjykimit C.nr.19/2013 me datë 29.06.2015, e ka miratuar kërkesëpadinë e paditësit E.Z., nga V.a duke konstatuar se i njëjti mbi bazën e shitblerjes është pronar i vetëm dhe ekskluziv i ngastrës kadastrale nr.P-73701026-01041-1, me sipërfaqe prej 7664 m², në vendin e quajtur “Brestovi Utrina” në Zonën Kadastrale KK., me përkufizimet si në ekspertizën e ekspertit gjeodet, dhe si të tillë duke e ndarë nga bashkëpronësia.

Kundër këtij vendimi i autorizuari i të paditurës S.D., av. F.Y. kishte ushtruar ankesë, ndërsa Gjykata e Apelit me Aktvendimin Ac.nr.3529/15, e ka miratuar ankesën duke e prish Aktgjykimin C.nr.19/13 dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim në shkallë të parë.

Në procedurën e rigjykimit palët, sidomos pala paditëse ju është përmbajtur udhëzimeve të dhëna nga Gjykata e Apelit, nga e cila është kërkuar plotësimi dhe përmirësimi i padisë, duke qartësuar kërkesat, se për cilat sende-paluajtshmëri nga bashkëpronësia duhet të nënshtrohen ndarjes apo pjesëtimit dhe cila pasuri i takon paditësit si pasuri e tij e veçantë.

Kështu me parashtresën e datës 14.01.2021, i autorizuari i paditësit ka bërë precizimin-rregullimin e padisë, duke kërkuar vërtetimin e pronësisë dhe ndarjen e bashkëpronësisë, me theks të qartë ka kërkuar: Ndahet nga bashkëpronësia e ngastrës kadastrale nr.1041-1, në vendin e quajtur “Brestovi Utrina” me sipërfaqe prej 7664 m², ZK KK..

Gjykata të gjithë të paditurve bashkë me ftesa, precizimin e padisë nga paditësi ju kishte dërguar 25 ditë para datës së seancës përgatitore.

Ndërkohë nga “i autorizuari i paditëses” Z. P., H.I.si paditëse në lëndën C.nr.400/14 me bazën për anulimin e kontratës së shitblerjes dhe vërtetimin e pronësisë në bazë të shitblerjes, ka pranuar parashtresën e datës 18.12.2020, për bashkimin e lëndës objekt shqyrtimi me lëndën C.nr.400/14, të cilën parashtresë gjitha palët dhe përfaqësuesit e tyre në seancën e datës 02.03.2021, ishin deklaruar se e kundërshtojnë, duke e arsyetuar se paditësja nga lënda 400/14, asnjëherë nuk ka qenë palë në procedurë në lëndën konkrete.

Gjykata e kishte refuzuar propozimin e tillë për bashkimin e lëndëve me arsyetimet se objekti kontesteve në këto dy lëndë nuk është i njëjtë, palët janë të ndryshme, si dhe nga fakti se gjithë ndërgjyqësit ishin kundër propozimit për bashkimin e lëndëve. Në këtë seancë gjykata kishte kuptuar nga avokati F.Y. se i padituri P.M. kishte ndërruar jetë me datë 11.12.2012 në

Beograd, andaj nga pala paditëse kishte kërkuar që të rregullohet padia, pasi që gjykata me Aktvendimin e datës 02.03.2021 e ka ndërprerë procedurën kontestimore, pas vdekjes së të paditurit P.M..

Pas rregullimit të trashëgimisë pas vdekjes së të paditurit, gjykata me Aktvendimin CT.nr.13/2021, trashëgimtarë në pasurinë e të ndjerit ka shpallur të paditurit; P.Z. X.S.D. X. G.J. M.që të tria vajza të hallës së trashëgimlënsit, T.B. M.dhe T.Z., djemë të hallës së trashëgimlënsit, secili në pjesën prej 96/1008, në tërë paluajtshmërinë e evidentuar në emër të trashëgimlënsit.

Edhe në seancën e datës 17.01.2022, ishte paraqitur kërkesa dhe nevoja për precizimin dhe rregullimin e padisë, sidomos pas rregullimit të procedurës trashëgimore pas vdekjes së të maditurit P. M.. Po ashtu, ishte parashtruar edhe kërkesa për nxjerrjen e historiatit të ngastrës kadastrale bazë nr.1041-0, e rrjedhimisht edhe për ngastrën e krijuar nga ngastra bazë, ngastra nr.1041-1, Klokot.

Nga përgjigja lidhur me historiatin e kërkuar, Zyra Kadastrale Komunale (ZKK) në KK., ka njoftuar se nga ngastra bazë 1041-0, ishin krijuar katër njësi të reja të ndara, të cilat ndarje kishin ndodhur gjatë V.t 2009. Përmes kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë Vr.nr.1926/2012 e datës 02.08.2012, blerësi, tani paditësi E.Z. ishte regjistruar si bashkëpronarë në katër njësitë e reja të krijuara nga ngastra bazë 1041-0, në secilën ngastër me 672/1008, apo me 4/7, të pjesës ideale.

Në seancën e datës 11.05.2022, përfaqësuesi i paditësit av. E.A., ndër të tjera ka thënë, se nga shqyrtimet dhe provat e administruara në procedurën e mëparshme është vërtetuar se paditësi mbi bazën e kontratave mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, duke specifikuar; kontratat Vr.nr.1251/08, datë 30.07.2008, kontratën Vr.nr.1337/2010 e datës 05.07.2010 dhe kontratën Vr.nr.1926/2012 e datës 02.08.2012, të cilat kanë krijuar efekt të plotë juridik ndërmjet palëve dhe si të tilla bazuar në nenin 36 të LPDS paraqesin titull juridik për fitimin e të drejtës së bashkëpronësisë së paditësit në njërën anë dhe të paditurve në anën tjetër, në pjesën numerike alikuote si në kontrata. Edhe nga deklarata e dhënë nga i padituri X.T. me datë 17.08.2011, deklarata e dhënë nga N.S.me datë 24.10.2011 dhe deklarata e dhënë nga ish i padituri P.M. (.), vërtetohet se mes ndërgjyqësve ishte bërë ndarja fizike në proporcion si në pjesët numerike, e pastaj me vullnetin e tyre janë pajtuar që eksperti gjeodet ti identifikoj ngastrat lëndore, ndërsa pala shitëse, tani e paditur është pajtuar që paditësi të hy në posedim dhe shfrytëzim të ngastrës 1041-1, me 7664 m², pa u penguar nga palët kontraktuese.

Përfaqësuesi i të paditurës S.D., av. F.Y., ka vazhduar ta kontestoj precizimin e padisë së paditësit, duke e konsideruar se precizimi i tillë është ende i pa qartë, duke e kontestuar edhe historiatin e ngastrës kadastrale bazë 1041-0, të ndarë në 5 ngastra të reja, të dorëzuar nga ZKK-ja në KK..

I autorizuari i paditësit av. E.A.ju ishte përgjigjur përfaqësuesit të autorizuar të paditurës av. F.Y., lidhur me ekzistimin apo jo të ndarjeve formale, duke iu përgjigjur se ndarja fizike e një paluajtshmërie mund të bëhet sipas mënyrës faktike, si në rastin konkret, pasi që secila palë kontraktuese ka në posedim të pjesës së vet, e paditësi pjesët e blera me kontratë ka fillu ti posedoj, shfrytëzoj dhe disponojë.

Ndërsa, të autorizuarit të paditurës P.Z., av. F.B. lidhur me sigurimin e edhe të një rrjedhe historike të ngastrës kontestuese nga ZKK në Klokot, ju ishte përgjigjur se në kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmërisë Vr.nr.1926/2012 e datës 22.08.2012, ngastra kadastrale nr.1041-1, me kulturë bujqësore, në sipërfaqe prej 7664 m², është si njësi e plotë kadastrale dhe e regjistruar si e tillë.

Gjykata kishte urdhëruar ekspertin gjeodet të nxjerr ekspertizë plotësuese, duke identifikuar dhe përkufizuar sipërfaqen prej 7664 m² të ngastrës 1041-1, ZK KK., të cilën ekspertizë pasi e

ka pranuar gjykata me datë 28.06.2022, i ka dërguar palëve, ndërsa pala paditëse pas pranimit të ekspertizës kadastrale, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë me parashtrësën e datës 18.07.2022.

Ndërsa, i autorizuari i tij av. E.A.ka thënë se në bazë të provave të prezentuara nga paditësi bindshëm është vertetuar se paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë individuale, në paltuajshmërinë, e cila është precizuar në parashtrësën e paditësit për precizimin e kërkesëpadisë me datë 18.07.2022. Me ekspertizën e ekspertit gjoedet të datës 28.06.2022, ishte identifikuar prona kontestuese me gjitha matjet e sakta, në të cilën paditësi e ka gëzuar të drejtën e bashkëpronësisë- pjesës alikuote, sikurse ishte konstatuar në ekspertizë. Shitësit ia kanë dorëzuar në posedim dhe shfrytëzim të qetë pjesën e palujtshmërisë të cilat i kanë takuar paditësit, ndërsa paditësi e ka përmbush në tërësi detyrimin e tij kontraktues, ndaj të paditurve si shitësa. Kontratat janë vërtetuar në gjykatë, dhe mbi bazën e tyre, pjesët numerike të njësisë kontestuese kanë kaluar dhe janë regjistruar në bashkëpronësi të paditësit si blerës.

Kontratat e lidhura dhe të vërtetuara në gjykatë paraqesin bazë juridike për fitimin e drejtës së bashkëpronësisë. Këto kontrata kanë kriju efekt juridik të plotë deri sa ishin gjallë paraardhësit e tyre dhe këto pjesë të paluajtshmërive mbi të cilat paditësi e ka fituar të drejtën e bashkëpronësisë, në sipërfaqet e tyre që e përbëjnë sipërfaqen kontestuese, sipas identifikimit që e ka bërë gjeodeti, e përbëjnë paluajtshëmërinë, që mbi bazën e drejtës së bashkëpronësisë, paditësi ta fitoj të drejtën e pronësisë individuale.

Përfaqësuesi i të paditurës S.D., av. F.Y., ka paraqitur vullnetin që palët të dakordohen dhe përmes kontratës noteriale ta ndajnë paluajtshmërisë, secili të vetën. Kishte vërejtje në përmbajtjen e parashtrësës mbi precizimin e kërkesëpadisë së datës 18.07.2022, duke theksuar se nuk ishin përmendur gjithë emrat e të paditurve në këtë parashtrësë, pastaj se pala paditëse vazhdimisht po e përmend të drejtën në bashkëpronësi e jo në pronësi, duke vazhduar se nga vendi i ngjarjes kemi vërejtur se ngastra kontestuese nuk është e kuptueshme sipas numrave numerik të ngastrave. Kjo paluajtshmëri deri më tani nuk është shfrytëzuar nga askush, por më tepër është si djerrinë,

Përmendet se paditësi e ka vertetuar faktin se palujtshmëria kontestuese mbi bazën e kontratës mbi shitblerjen të cilat gjatë rrjedhes se procedurës janë përmendur e këto janë përmbushur nga palët kontraktuese. Neve na takon te kontestojme këtë pjesë, pasi që nëse e shiqojmë në detaje mënyrën se si është blerë, mund të vërtetohet se kemi të bejme me fitimit e të drejtës në mënyrë jo ligjore duke treguar shitësin si pronar të vetëm edhe atë në bazë të trashëgimisë të babait të tij dhe xhaxhallarëve të tij. E vërteta është se xhaxhallarët e tij nuk kanë pasur fëmijë, atëher nuk ka mundur shitësi të jetë trashëgimtar i vetëm. Andaj edhe regjistrimi i kësaj paluajtshmërie është bërë me veprime të kundërligjshme.

I padituri dhe përfaqësuesi i të paditurve T.Z., ishte shprehur se është në dispozicion të zgjidhjes se këtij kontesti me marrëveshje.

Përfaqësuesi i të paditurës Z. P., I.S., kishte thënë se është i autorizuar nga e paditura Z. që të kërkojme zgjidhje me marrëveshje, ndërsa sa i përket kërkesëpadisë së paditësit e kontestoj kerkese padine e tij pjeserisht, për arsye se nuk i takon aq sa kërkon paditësi, pasi që sipas aktvendimit të trashëgimisë të V.t 2010 T.nr.64/2010, trashëgimtar i M. P. nuk ka mundur të jetë trashëgimtar i vetëm i trashëgimlënësit . P., pasi që përveç M. P.it në atë kohë kanë qenë gjallë të gjithë tjerët si Spasena, Mlladena e Velika. Andaj, sipas meje paditësit do ti takonte në mënyrë të pa kontestueshme sipërfaqja jo më e madhe se 38 ari, ishte shprehur ky përfaqësues.

Gjitha palët kishin propozuar dhe ishin pajtuar që të lexohen dhe administrohen provat.

Provat e adminstruara me procesverbalin e seancës së datës 22.05.2015: Certifikata e pronës me nr.UL-73701026-00069, ZK KK., e datës 28.12.2012, Kopja e planit e datës 06.09.2012, me 4 ndarjet e ngastrës 1041, Deklarata Vr.nr.2330/11, e datës 17.08.2011, e dhënë nga T.X., Deklarata UZP, e datës 25.02.2011, e dhënë nga P. Z., e vërtetuar tek noteri Muamed Shehu, me seli në Shkup të Maqedonisë, Deklarata Vr.nr.1649/2010, date 28.07.2010, e M. (.) P., Deklarata Vr.nr.1644/2010, datë 28.07.2010, e dhenë nga S.R., Deklarata Vr.nr.1645/2010, e datës 28.07.2010, e dënë nga Zhivorad (Blazha) Nisiq, Kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë Vr.nr.1251/2008, e dates 30.07.2008, Kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë Vr.nr.1387/2010, e datës 05.07.2010, Kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë Vr.nr.1926/2012, e datës 02.08.2012, të gjita të vërtetuara në Gjykatën Komunale të V.së dhe Ekspertiza e ekspertit gjeodet Feat Shaqiri, e datës 31.10.2014, për ngastrat kadastrale 1041-1 dhe 1041-2, ZK KK., e cila përmban edhe koordinatat e terrenit.

Ndërsa, provat të cilat janë administruar në rirpodurë të kësaj çështje; Aktvendimi CT.nr.13/2021, i datës 05.11.2021, Përgjigja e ZKK-se në KK., e datës 06.04.2022, ndërsa e protokoluuar nga kjo zyrë me nr. 418/05, e datës 06.04.2022, Ekspertiza plotësuese kadastrale e hartuar nga eksperti gjeodet Feat Shaqiri, e dorëzuar me datë 28.06.2022, historiat i ngastrës bazë 1041-0, ZK KK., me parcelizmiet e saj ne 4 njësi të reja, e dorëzuar në gjykatë me datë 11.11.2022, Certifikata e pronës me ngastrën nr. 1041-1, ZK KK., në bashkëpronësi të 8 pronarëve e datës 08.11.2022, Ekstrakti i gjendjes civile për T.X., i datës 20.12.2022, ndërsa certifikata e vdekjes për të ndjerin T.X. me nr. rendor 23, e datës 20.12.2022, Aktvdekja nr. 07/2023, e datës 08.05.2023, e lëshuar nga ZGJC në KK., Aktvendimi i ZKK-së në KK., nr. 154/2023, datë 23.01.2024, Certifikatat e pronës me ngastrën kontestuese 1041-1, si dhe 9 ngastra tjera të gjitha në ZK KK., si dhe Certifikata e pronës me ngastrën 1041-1, në emër të 7 bashkëpronarëve, e dates 09.02.2021.

Pala paditëse nuk kishte vërejtje në provat e lexuara, ndërsa i autorizuari i të paditurës S.D., avokati F.Y., ishte deklaruar se vërejtjet eventuale do ti paraqiste në fjalën përfundimtare Ndërsa të paditurit e tjerë nuk kishin vërejtje në provat e lexuara.

Gjykata me kërkesën e palëve ka lejuar që fjalën përfundimtare ta paraqesin në formën e shkruar, duke e këmbyer të njëjtën për palët.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i paditësit, av. E.A., në mesin e tjerave ka përsëritur se, me këtë çështje kontestuese është vërtetuar fakti se paditësi mbi bazën e kontratave për shitblerjen e paluajtshmërisë e vërtetuara në Gjykatën Komunale në V., Vr.nr. 1251/2008 e datës 30.07.2008 e ka fituar të drejtën e bashkëpronësisë në 1/7 pjesë të paluajtshmërisë së përshkruar detajisht në pikën I. të kontratës, ndërsa me Kontratën për

shitblerjen e paluajtshmërisë e vërtetuar në Gjykatën Komunale në V., Vr.nr. 1387/2010 datë 05.07.2010, vërtetohet se paditësi e ka fituar të drejtën e bashkëpronësisë në 3/7 pjesë numerike nga njësia kadastrale nr. 1041-0 në sipërfaqe prej 13413 m² si tërësi, në vendin e quajtur “Brestovi Utrina” e cila kontratë për së gjalli të paraardhësit të paditurve P. Mumqillo (.) nga K. është përmbushë në tërësi.

Me Kontratën për shitblerjen e paluajtshmërisë, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në V., Vr.nr. 1926/2012 e datës 02.08.2012 është vërtetuar se paditësi mbi bazën e kësaj kontrate e ka fituar të drejtën e bashkëpronësisë në 32/1008 pjesë numerike të njësisë kadastrale 1041-1 bashkë me njësitë tjera kadastrale që janë përshkruar detajisht në pikën I. të kontratës e cila kontratë është përmbushë në tërësi pasi që shitësit Z. Zhivojin P. nga K., Martin (nëna Z.) P. nga Shkupi dhe A. (nëna Z.) P. nga Shkupi si shitës ia kanë dorëzuar paditësit si blerës në posedim pjesën e paluajtshmërisë së shitur dhe shitësit kanë pranuar që kjo pjesë e

paluajtshmërisë së shitur në regjistrat e paluajtshmërive të regjistrohesh në bashkëpronësi të paditësit.

Me daljen e gjykatës në vend me ekspert të gjeodezisë me datë 31.10.2014 është vërtetuar se ngastra kontestuese nr. 1041-1, por edhe ngastrat tjera të ndara kanë qenë të pashfrytëzuara, dhe nuk është vërejtur vija ndarëse ndërmjet ngastrës 1041-1 dhe 1041-2, por në pjesën jugore në kufij të këtyre dy ngastrave është gjetur një dru në formë të hunjit-shtyllës i ngulitur në tokë të cilin e kishte vendosur paditësi para 5 apo 6 viteve në prezencën e V., M., P. M., N.S.it dhe T.X.. Po ashtu në anën tjetër në mbarim të kësaj ngastrë e cila ndan ngastrën 1041-2 është mbjellur një pemë-kajsi dhe vendosur një gurë i vogël e që sipas ekspertit të gjeodezisë ky guri simbolizon vijën kufitare ndërmjet njësive kadastrale 1041-1 dhe 1041-2. Eksperti i gjeodezisë në vend ka konstatuar se matjet dhe piktimet e ngastrave kadastrale 1041-1 dhe 1041-2 kanë rezultuar se pikat kanë qenë të caktuara dhe të shënuara në terren me rastin e ndarjes fizike të tyre të cilat ishin në harmoni të plotë me gjendjen juridike.

Me ekspertizën kadastrale të ekspertit të gjeodezisë Fehat Shaqiri e datës 28.06.2022, e cila nuk është kontestuar nga të paditurit dhe të autorizuarit të tyre është vërtetuar fakti se në terren eksperti ka bërë identifikimin dhe piketimin-ekzekutimin e mexhës se një pjese të caktuar të ngastrës kadastrale 1041-1 në sipërfaqe prej 7664 m², respektivisht ngastrës nr.1041-2 në sipërfaqe prej 1916 m² në bashkëpronësi juridike të përshkruara në certifikatën pronësore ZK. KK..

Nga sa u theksua më lartë rrjedh se paditësi mbi bazën e kontratave për shitblerjen e paluajtshmërisë të cilat u theksuan më lartë e që ndërmjet palëve ndërgjyqësore nuk ishin kontestuese si dhe mbi bazën ndarjes fizike si dhe mexhave të cilat janë konstatuar në terren, e që në këtë rast vërtetojnë faktin se ndarje fizike e kësaj paluajtshmërie është bërë ndërmjet palëve kontraktuese në mënyrën sikurse ka konstatuar eksperti i gjeodezisë dhe kjo ndarje fizike përderisa kanë qenë gjallë paraardhësit e të paditurve nuk është kontestuar, për këtë arsye paditësi mbi këtë bazë juridike e ka fituar të drejtën e pronësisë individuale në njësinë kadastrale nr. 1041-1 në sipërfaqe prej 7664 m², me matje dhe përkufizime të cilat janë konstatuar në skicën e ekspertizës kadastrale të ekspertit të gjeodezisë Feat Shaqiri e dt. 28.06.2022.

Ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore, duke i specifikuar; për përpilimin e padisë shumë prej 208 €, për përpilimin e parashtresës për precizimin e kërkesëpadisë shumë prej 208 €, për përfaqësim nga avokati me të paditësi me mbi pesë të paditur në shtatë (7) seanca të mbajtura shumë prej nga 810 € dhe shpenzimet e udhëtimit në relacion

Prishtinë-V. në shumë prej 210 €, për shpërblimin e ekspertit të gjeodezisë për dy ekspertiza shumë prej 250 € dhe për përpilimin e fjalës përfundimtare shumë prej 550 €, apo gjithsej ka kërkuar shumë prej 7,096 euro.

- Ndërsa i autorizuarit i të paditurës S.D., av. F.Y., në fjalën e tij përfundimtare ka thënë se gjykata e ka mbyll shqyrtimin kryesor të kësaj lënde pa u plotësuar kushtet për përfundimin e saj, duke konsideruar se edhe pse kjo gjykatë ka bërë bashkimin e kësaj lënde me lëndën C.nr.105/12, duke e marrë shenjën unike C.nr.19/13, pastaj përsëri e kishte veçuar pasi që padinë në lëndën C.nr.105/12 e kishte konsideruar të tërhequr me Aktvendim të veçantë, kundër të cilit Aktvendim ishte ushtruar ankesë, ndërsa Gjykata e Apelit e kishte anuluar Aktvendimin C.nr.105/12 të datës 27.01.2015, duke e kthyer lëndën në rivendosje.

Pastaj, ka shtuar se ZKK në KK. nuk mund ta japë kopjen e planit, sepse nuk ka parcelizim të ngastrës 1041-1 me përmasa dhe kufij, duke shkuar deri te kontestimi i pjesëve ideale të pronës tek bashkëpronarët të një rangui, ndërsa përqindja ndryshon.

Ndërsa, në plotësimin e fjalës përfundimtare i njëjti përfaqësues i të paditurës S.D., madje duke e konsideruar veten se është edhe përfaqësues i të paditurës P.Z. nga Smedereva (i cili në fakt nuk ka autorizim nga kjo e paditur), shprehet për lëshime të çështjeve teknike siç është mungesa e vlerës së kontestit, pastaj mungesa e pagesës së taksës për padi, e deri te mungesa e kopjes së planit të ngastrës 1041-1, ZK KK., të cilën nuk mund ta nxjerr zyra kadastrale, në mungesë të ndarjes/parcelizimit të kryer.

Gjykata duke u bazuar në nenin 8, të LPK-së, veçoi provat veç e veç dhe si tërësi.

- Certifikata e pronës me nr.UL-73701026-00069, ZK KK., e datës 28.12.2012, dëshmon dhe vërteton se paditësi E.Z., ishte bashkëpronarë me 672/1008, apo më thjesht me 4/7, të pjesës ideale në ngastrën kontestuese nr.1041-1.

- Me leximin e kopjes së planit të datës 06.09.2012, me 4 ndarjet e ngastres 1041-0, gjykata vërteton se ngastra kadastrale nr.1041-0, ZK KK. ishte ndarë në 4 ndarje apo njësi të reja, ku ngastra e re nr.1041-1, kishte sipërfaqën prej 7664 m², prandaj sipas kësaj kopje të planit ngastra 1041 nuk paraqitej si tërësi, siç pretendonin disa nga përfaqësuesit e të paditurve, por ishte e ndarë në 4 njësi.

- Me leximin e Deklaratës Vr.nr.2330/11, të datës 17.08.2011, e dhënë nga T.X., gjykata vërteton se paditësi E.Z. paraprakisht e kishte siguruar pëlqimin nga bashkëpronarët e tjerë për ta blerë pjesën e ngastrës 1041-0, nga Z. P. dhe M. P., me këtë rast ata i kishin caktuar edhe kufijtë e sipërfaqes së blerë, duke filluar nga këndi, respektivisht udhëkryqi i rrugës regjionale KK.-Ferizaj dhe në anën tjetër të rrugës KK.-V.. Pastaj me daljen e gjeodetit në vendin e ngjarjes edhe ishte ndarë sipërfaqja e kontraktuar, duke u parcelizuar dhe evidentuar si ngastër 1041-1, pastaj duke i përmendur edhe gjithë bashkëpronarët tjerë, me rastin e ndarjes së ngastrës, e në prani edhe të Novices.

- Deklarata Nr.Br. UZP, e datës 25.02.2011, e dhënë dhe e përpiluar në gjuhën maqedone nga P. Z., e vërtetuar tek noteri Muamet Shehu, me seli në Shkup të Maqedonisë Veriore, gjykata vërteton se kjo e paditur ia kishte shitur paditësit E.Z. 1/7, e pjesës ideale të ngastrës nr.1041, në ZK KK., e cila ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 13413 m², ndërsa kur e pjestojmë dhe ndajmë numerikisht i bie që i ka shitur sipërfaqen prej 1916 m². Po ashtu, kjo e paditur në deklaratë ka cekur edhe pozicionin e sipërfaqes së shitur, i cili përputhet në tërësi si në pikën I. të këtij aktgjykimi.

- Deklarata Vr.nr.1649/2010, datë 28.07.2010, e dhënë nga M. (.) P., e dhënë dhe e përpiluar në gjuhën serbe, e vërtetuar në gjykatën Komunale në V., gjykata vërteton se nga ky i paditur paditësi E.Z. kishte blerë 3/7 e pjesës ideale të ngastres kontestuese nr.1041, apo numerikisht kishte blerë 5748 m². Po ashtu, nga kjo deklaratë vërtetohet se paditësi kishte përmbushur obligimin në tërësi ndaj këtij të padituri.

- Deklarata Vr.nr.1644/2010, date 28.07.2010, e dhënë nga S.R. dhe Vr.nr.1645/2010, e datës 28.07.2010, e dhënë nga Zhivorad Blazha Nisiq, të përpiluara në gjuhën serbe, ndërsa të vërtetuara në Gjykatën Komunale në V., gjykata njoftohet se të ndjerët S. dhe C. S., ishin deklaruar se ia kishin lënë nipit të tyre M. P.it, gjithë pasurinë e paluajtshme, që i bie 1/7-tat të pjeseve të tyre ideale, duke përfshirë edhe atë në ngastrën kontestuese nr.1041-0.

- Me leximin e Kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e vërtetuar në gjykatë me shenjën Vr.nr.1251/2008, e datës 30.07.2008, e lidhur ndërmjet Z. P.it si shitëse dhe E.Z., si blerës, gjykata vërteton se blerësi-tani paditësi E.Z. nga e paditura e cila ishte pronare e 1/7, e pjesës ideale të pronës në disa ngastra apo 7 sosh, duke përfshirë edhe të ngastrës 1041-0.

- Kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë Vr.nr.1387/2010, e datës 05.07.2010, vërteton se paditësi E.Z. nga i padituri M. P., i cili ishte pronar i 3/7, së pjesëve ideale të pronës në disa ngastra apo 7 sosh, duke përfshirë edhe të ngastrës 1041-0, e i cili i kishte blerë 3/7 për gjitha ngastrat në pjesët ideale.
- Me leximin e Kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë Vr.nr.1926/2012, e datës 02.08.2012, gjykata vërteton se paditësi E.Z. nga Z. P. dhe fëmijët e saj M. dhe A., kishte blerë 32/1008 të pjesëve ideale të 10 ngastrave, duke përfshirë edhe të ngastrës tanimë të ndarë dhe parcelizuar me nr.1041-1, me sipërfaqën prej 7664 m², ndërsa çmimi i shitblerjes për gjitha këto sipërfaqe të pjesëve ideale ishte kontraktuar dhe paguar çmimi kontraktues.
- Ekspertiza kadastrale e ekspertit gjeodet Feat Shaqiri, e datës 31.10.2014, për ngastrat kadastrale 1041-1 dhe 1041-2, ZK KK., konstatohet se nga të dhënat e marra nga operati i fundit kadastral (dmth nga certifikata e pronës dhe kopja e planit), vërtetohet siç shkruan edhe me shkronja të hijezuara se ngastra nr.1041-0, ishte e ndarë në 4 njësi apo nënngastra tjera. Sipas këtij konstatimi ngastra nr.1041-1, që prej datës së vrojtimit të saj në terren me 31.10.2014, përmbante edhe koordinatat e terrenit, apo pikat e caktuara veç ishin të shënuara dhe vendosura për këtë ngastër dhe në mes të kësaj ngastre dhe ngastrës fqinje 1041-2, ekzistonin shenja fizik në dy anët e këtyre ngastrave, të cilat përkufizonin ngastrat, ashtu siç paraqiten edhe tekstualisht me sipërfaqe.
- Ekspertiza plotësuese kadastrale e hartuar nga po i njëjti ekspert gjeodet Feat Shaqiri, e dorëzuar me date 28.06.2022, e përkufizon ngastrën kontestuese nr.1041-1, në katër anët e saj me ngastrat e ndryshme, ndërsa në anën jugore kufizohet me ngastrën 1041-2, e cila po ashtu është derivat nga ngastra bazë 1041-0.
- Me Aktvendimin CT.nr.13/2021, i datës 05.11.2021, gjykata për trashëgimtarë të të ndjerit (i cili ishte edhe i paditur) P.M. (.), në tërë pasurinë e paluajtshme trashëgimore apo në 10 ngastrat, përfshirë edhe ngastrën tani kontestuese me nr.1041-1 me 7664 m².
- Certifikata e vdekjes për të ndjerin T.X. me nr. rendor 23, e datës 20.12.2022, vërteton se ky i paditur kishte ndërruar jetë me date 13.12.2022, ku gjykata ka ndërprerë procedurën, ndërsa bazuar në Aktvdekjen nr. 07/2023, e datës 08.05.2023, e lëshuar nga ZGJC në KK., si trashëgimtarë ligjor të ndjerit Xhorxhe ishin shënuar të paditurit; Z. Tomiq, D. Tomiq, Jasmina Xhokiq, Boban e Zharko Tomiq, të cilëve iu ishte rritur përqindja e pjesës ideale të pronës në 10 ngastrat, përfshirë edhe ngastrën kontestuese 1041-1.
- Përgjigja e ZKK-se në KK., e datës 06.04.2022, ndërsa e protokoluar nga kjo zyrë me nr. 418/05, e datës 06.04.2022, tregon se ngastra bazë 1041-0 ishte ndarë në 4 nënndarje, të cilat ishin regjistruar, ku ngastra 1041-1 kishte 7664 m², deri sa paditësi E.Z. ishte i regjistruar si bashkëpronarë me 672/1008 të pjesëve ideale në të gjitha nënndarjet, deri sa të 5 të paditurit mbajnë pjesën tjetër prej 165/1008. Sipas kësaj përgjigje parcelizimi, kishte ndodhë me kërkesën apo fletëparaqitjen për parcelizim nr.117/2009, e paraqitur me datë 15.12.2009, me nr.88 të librit, me nr. protokollit 106/09. Kjo zyrë kadastrale e K.t ka theksuar se të dhënat i kanë nxjerr nga libri për regjistrimin e ndarjeve të ngastrave kadastrale, ndërsa kopja e lëndës-kërkesa kishte mbetur në Zyrën kadastrale në V., pasi që Komuna e K.t ishte themeluar gjatë V.t 2010.

Nuk ka dilemma se ndërmjet paditësit E.Z. dhe të paditurve P.M., P. Z. dhe dy fëmijëve të saj M.t dhe Aleksandres, ka ekzistuar dhe ndodhur raporti juridiko-civil kontraktues, i arritur

dhe lidhur me vullnetin e plotë të tyre, si dhe me respektimin e plotë të dispozitave ligjore, siç parashihet me ligj. Padiësi E.Z. përmes tri Kontratave mbi shitblerjen e paluajtshmërive dhe atë; Vr.nr. 1251/2008, e datës 30.07.2008, Vr.nr.1387/2010, e datës 05.07.2010 dhe Vr.nr.1926/2012, e datës 02.08.2012, ka arritur ta argumentoj mënyrën e kontraktimit, pagesën e çmimit të kontraktuar për secilën kontratë dhe dorëzimin në posedim të paluajtshmërisë së kontraktuar nga secili shitës, këto konstatime nuk ishin kontestuese mes palëve.

Peshën e veçantë dhe dominuese se padiësi e kishte fituar të drejtën në bashkë/pronësi me pjesët numerike dhe alikuote për gjykatën ishin tri kontratat mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, të lidhura ndërmjet padiësit E.Z. dhe të paditurve P. M. dhe P. Z., të cilat kontrata edhe janë ekzekutuar në operatin kadastral, sepse ishin të vërtetuara para organit kompetent-gjykatës, duke u lidhur me pajtimin e dy anshëm dhe të plotë të vullnetit.

Edhe deklarata e të paditurit T.X., çdo herë ishte dhënë me siguri të lartë dhe paraqiste besueshmëri tek të paditurit tjerë, por edhe tek gjykata, duke mos u ndryshuar asnjëherë. Deklarata e T.X.s e dhënë në gjykatë dhe e vërtetuar me shenjën Vr.nr.2330/11, e datës 17.08.2011, vërteton dilemat se padiësi E.Z. me babain e vet S.Z., ishin në shtëpinë e Xhorxhes në KK., të cilët atë dhe gruan e tij e kishin pyetur se a japin pëlqimin që ta blejmë nga Z. P. si bashkëpronare me 1/7 dhe pjesën e M. P.it prej 3/7, të ngastrës 1041-0, ndërsa dëshmitari iu ishte përgjigjur se unë dhe bashkëshortja ime, sikur edhe balldyzka e tij S.Veljika (Milan) dhe S.M., ndërsa sipas kësaj deklarate të gjithë ia kishin dhënë pëlqimin, ku njëkohësisht i kemi caktuar masat dhe kufijtë, duke i ndarë sipërfaqet e shitura nga Z. dhe M., duke filluar nga rruga G.-KK.-Ferizaj dhe në drejtim të rrugës për V., duke e ndarë në drejtim të kishës. Më pas ka dal edhe gjeometri, i cili e ka ekzekutuar këtë ndarje, ku pjesa e tyre e blerë do të ndahet dhe regjistrohet si ngastër e ndarë dhe do të merr numrin 1041-1, deri sa bashkëshortja e tij do ti merr 1/7 e pjesës ideale pas kësaj ndarje e cila do e merr numrin si ngastër 1041-2, pastaj velika do e merr ngastrën e ndarë 1041-3 dhe në fund ngastrën nr.1041-4 do ta merr Mlladena, të cilën edhe më herët e kishte shfrytëzuar, ku kishte pasur edhe pusin-

bunarin me çeshme, me të cilën e kishin ujitur bashçen. Gjatë kësaj ndarje kishte qenë prezent edhe kumbara i tij Novica. Sipas kësaj deklarate vërtetohet se padiësit iu ishte bërë edhe dorëzimi i paluajtshmërisë-sendit, të ndarë në vendin e ngjarjes.

Rikujtojmë se edhe dy të paditurit T.Z. dhe T.B., në seancën kryesore të datës 22.05.2015, gjatë fjalës së tyre përfundimtare kishin pranuar pjesërisht kërkesëpadinë e padiësit, matematikisht duke ia njohur dhe pranuar sipërfaqen prej 5400 m².

Edhe dalja dhe vrojtimi i drejtëdrejtë i gjykatës me ekspertin gjeodet në vendin e ngjarjes, na siguron se gjendja juridike e ngastres 1041-1, me sipërfaqe prej 7664 m², janë në përputhshmëri me gjendjen faktike të ndarë në terren.

Në anën tjetër të paditurit asnjëherë nuk e kanë kundërshtuar kërkesëpadinë dhe themelësinë e saj, për nga baza, por më tepër ata nuk pajtoheshin me veprimet juridike të personave dhe organeve tjera, para lidhjes së kontratave nga ana e padiësit.

Këtë kundërshtim e kishte shprehur edhe përfaqësuesi i të paditurës S.D., avokati F.Y., i cili në fjalën përfundimtare me shkrim, asgjë nuk kishte thënë lidhur me çështjen konkrete, të kësaj lënde, por e gjithë deklarata e këtij përfaqësuesi, si me rastin e parë, por edhe gjatë rivendosjes, është e fokusuar në çështje sekondare dhe jo relevante për çështjen konkrete, me qëllim të zvarritjes së çështjes, i cili disa herë në fjalën përfundimtare, paragjykon duke thënë se kjo lëndë do të priset nga gjykata e Apelit. Atë si duket më shumë e pengojnë çështjet që ndërliken me taksën për padi, vlerën e kontestit e gjëra tjera të parëndësishme, se me deklaratimet e tija përmbajtësore, të kontribuoj në zgjidhjen meritore të rastit.

Të paditurit nuk ishin interesuar se çfarë prova po sjell paditësi, sepse e dinin që sipërfaqen prej 7664 m², e kishte blerë paditësi, por atyre me tepër ju interesonte sipërfaqja e mbetur, kurse për ngastrën nr.1041-1, të paditurit ishin të pa interesuar, e kjo nënkupton se kërkesëpadinë e paditësit nuk e kundërshtonin. Tri kontratat mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, vërtetonin se paditësi e kishte blerë 4/7, e ngastres bazë 1041-0, e kjo sipërfaqe si tërësi ishte 13413 m², e që i bie se paditësit i takonte sipërfaqja prej 7664 m², aq sa edhe e kishte ndarë dhe kishte regjistruar si ngaster të veçantë. Para se ta blente paditësi sipërfaqen nga pronarët, ai në terren bashkë me shitësit e kishte identifikuar mirë se cilën ngastër po e blenë, pra e kishte blerë ashtu siç e kishin shfrytëzuar atëherë shitësit, por në pamundësi ta regjistronte ndarjen paditësi, ai e kishte blerë, ashtu siç ishte e regjistruar tekstualisht në kadastër.

Se paditësi e posedonte dhe shfrytëzonte sipërfaqen e blerë të ngastres nr.1041-1, flet edhe fakti kur Gjykata Themelore në G. me aktvendimin C.nr.586/2013, kishte vendosur se paditësin E.Z., e kishin penguar në shfrytëzimin e qetë të paditurit M.I.dhe H.I., nga L., Komuna e V.së. Po të mos ishte pronar i vetëm paditësi, nuk do të ushtronte padi për pengim posedimin, por këtë do ta bënin tani të paditurit.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse, ku nuk ka dyshim se pretendimet e palës paditëse ishin të bazuara në prova e fakte të vërtetuara në organe kompetente dhe të bazuara në ligje. Tri kontratat për shitblerjen e paluajtshmërisë të nënshkruara nga paditësi E.Z., ishin të lidhura në formën e shkruar.

Nëse i vlerësojmë pretendimet e të autorizuarës së paditurës S.D., avokatit F.Y., ato kryesisht bazoheshin në pakënaqësitë e tija të shprehura në vendimet e nxjerra nga organet gjyqësore, e në veçanti ato të nxjerra në procedurën jokontestimore, siç është Aktvendimi T.nr.64/2010, ku sipas këtij vendimi trashëgimtari M. P. nuk ka mundur

të jetë trashëgimtar i vetëm i trashëgimlënësit . P.. Por, pakënaqësitë e tilla ai nuk i kishte kundërshtuar, duke i pranuar në mënyrë të heshtur. Përfundimisht, për shkelje eventuale të procedurave trashëgimore të ndjerëve C.S.dhe SavoS.se a janë anashkaluar trashëgimtarët, pala që pretendon se ka interes juridik ka qenë dashur ti parashtrij prova gjykatës, edhe pse me asnjë vendim me të cilën ishte rregulluar trashëgimia, për sa i përket kësaj pjese të palujtshmërisë, nuk mund të ketë ansjë efekt vërtetues, me arsyetimin se paditësi e kishte fituar të drejtën e bashkëpronësisë sipas pjesëve alikuote, para se të bëhet shqyrtimi i trashëgimisë me aktvendim të gjykatës.

Po thuaj se i tërë theksi i tij i dhënë në fjalën përfundimtare dhe plotësimin e saj të dhëna me shkrim me datë 19.04.2024, është i drejtuar me vërejtjet ndaj kësaj gjykate, duke mos e pranuar të arsyeshëm veçimin e tani lëndës konkrete e cila mbante numrin para vendosjes së herës së parë C.nr.19/13 me lëndën C.nr.105/2012, ku në këtë të fundit paditës ishin S.D., P. Z. etj.

Ky përfaqësues ka thënë se Gjykata e shkallës së parë (kjo gjykatë), ka vendosur ti bashkoj lëndët C.nr.19/13 dhe 105/12, duke vazhduar shqyrtimet si lëndë unike C.nr.105/12. Me datë 17.01.2015, gjykata ka vendosur ti veçoj përsëri këto dy lëndë. Kjo gjykatë me Aktvendimin të veçantë lëndën C.nr.105/2012 me datë 27.01.2015, ka vendosur ta konsideroj të tërhequr padinë e paditëses S.D. etj. Kundër këtij Aktvendimi i autorizuari i saj av. F.Y. kishte ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila kishte anuluar Aktvendimin C.nr.105/12 të datës 27.01.2015, duke e kthyer lëndën në rivendosje.Në seancën e datës 07.05.2014, kemi kërkuar që përsëri lëndët të ribashkohen, ndërsa gjykata i ka bashkuar, duke marrë numrin C.nr.105/12, por shifet se gjykata e trajton lëndën si C.nr.863/2020, ndërsa lënda e paditëseve S.D., P. Z. etj. mbetet e pa shqyrtuar, andaj ky përfaqësues kërkon nga gjykata ta rihap procedurën, pasi që

mendon se nuk janë pjekur kushtet për të vendosur për këtë lëndë. Pastaj, sipas këtij përfaqësuesi vendimit i mungon vlera e kontestit, taksa për padi etj.

Lidhur me këto pretendime të këtij përfaqësuesi gjykata jep sqarime, pasi që avokati i palës paditëse tanimë kishte dorëzuar fjalën e tij përfundimtare.

Gjykata me përgjegjësi sqaron se nuk qëndrojnë këto konstatime të avokatit F.Y., por e vërteta është kjo: Gjykata kishte vendosur ti bashkoj lëndët C.nr.19/13 dhe 105/12, duke vazhduar shqyrtimet si lëndë unike C.nr.105/12. Në seancën kryesore me datë 17.01.2015, gjykata kishte vendosur që përsëri ti veçoj lëndët, pasi që paditësj S.D. etj. nuk e kishte paguar garancionin të caktuar nga gjykata për përfaqësuesen e përkohshme që përfaqësonte të paditurit P.M. dhe G.J., të caktuar nga gjykata në seancën e datës 23.12.2014, andaj gjykata e kishte konsideruar të tërhequr padinë e paditëses S.D., P. Z. etj. Pas ankesës së ushtruar nga avokatët e paditëses S.D. av.F.Y. dhe ai i paditëses F.B., kundër këtij Aktvendimi, në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit e kishte anuluar Aktvendimin C.nr.105/12 të datës 27.01.2015 (të konsideruar të tërhequr nga Gjykata e V.së), ndërsa lëndën e kishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata e Apelit në vërejtjet e saja, përmes Aktvendimit Ac.nr.893/2015, date 19.03.2019, veç tjerash e kishte udhëzuar gjykatën e shkallës së parë që nga përfaqësuesit e palëve paditëse av. F.Y. dhe F.B. të kërkoj rregullimin e padisë pasi që ishte konstatuar vdekja e të paditurit P.M. (i paditur në lëndën C.nr.105/12 dhe në atë C.nr.19/13), i cili kishte ndërru jetë me 11.12.2012 në Beograd, andaj ishte e domosdoshme rregullimi i padisë, sidomos nga avokatët që kishin ushtruar ankesë.

Kjo gjykatë me Aktvendimin C.nr.304/19, i datës 18.09.2019 (lënda C.nr.105/12 pasi ishte kthyer nga Gjykata e Apelit kishte marrë numrin e ri C.nr.304/19), i ka ftuar avokatët Faredin Ymeri dhe F.B. që madje brenda afatit prej 15 ditësh ta rregullojnë padinë, e në rast

se këtë nuk e bëjnë duke ia bërë me dije pasojat, por ata edhe pse personalisht këtë vendim e kishin pranuar me 25.09.2019, respektivisht av. Faruk me 23.09.2019, ata nuk kishin rregulluar padinë, andaj gjykata me Aktvendimin C.nr.304/19, datë 15.01.2021 e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditëseve S.D., P. Z. etj të tërhequr, i cili Aktvendim është bërë i plotfuqishëm me datë 10.02.2021.

Këto arsyetime nga gjykata i gjeni të radhitura një nga një me vendimet dhe fletëdorëzimet e përmendura, para këtij Aktgjykimi.

Nuk e kuptoj propozimin e avokatit kur thotë duhet rihapur procedurën, kur LPK-ja e zbatuar nuk e parasheh një normë të tillë, e aq më pak kur nuk ka bazë për rihapje, pasi që ai ka mund të ushtroj mjetin juridik, të cilën të drejtë nuk e ka ushtruar.

Sa i përket pretendimit tjetër të avokatit F.Y. se bashkëpronarët kurrë nuk kishin arritur marrëveshje për ndarjen e bashkëpronësisë, ky pretendim është i pa argumentuar, pasi që këtë pretendim më së miri e demanton Deklarata e të paditurit T.X. e dhënë në gjykatë dhe e vërtetuar me shenjën Vr.nr.2330/11, e datës 17.08.2011, i cili ishte edhe bashkëpronar i ngastrës 1041-1, ku kishte pranuar se ai dhe bashkëshortja e tij, sikur edhe balldyzka e tij S.V. dhe S.M., e kishin dhënë pëlqimin për shitjen e ngastrës, duke i caktuar masat dhe kufijtë, duke i ndarë sipërfaqet e shitura nga Z. dhe M., duke filluar nga rruga G.-KK.-Ferizaj dhe në drejtim të rrugës për V., duke e ndarë në drejtim të kishës. Më pas ka dalë edhe gjeometri, i cili e ka ekzekutuar këtë ndarje, ku pjesa e tyre e blerë do të ndahet dhe regjistrohet si ngastër e ndarë dhe do të marrë numrin 1041-1, deri sa bashkëshortja e tij do të marrë 1/7 e pjesës ideale pas kësaj ndarje e cila do të marrë numrin si ngastër 1041-2, pastaj Velika do të marrë ngastrën e ndarë 1041-3 dhe në fund ngastrën nr.1041-4 do të marrë Mlladana, të cilën edhe më herët e kishte shfrytëzuar, ku kishte pasur edhe pusin-bunarin me çeshme, me të cilën e kishin ujitur bashçen. Gjatë kësaj ndarje kishte qenë prezent edhe kumbara i tij Novica. Sipas kësaj deklarate paditësit iu ishte bërë edhe dorëzimi i paluajtshmërisë-sendit, të ndarë në vendin e ngjarjes.

Ndërmjet ndërgjyqësve/bashkëpronarëve kurr nuk ka qenë kontestuese, përse paditësi po e merr ngastrën e caktuar në vendin e caktuar, por kontestuese ishte sa sipërfaqe po ju mbetet tani të paditurve. Ndërsa, pretendimi tjetër i avokatit F.Y. se ngastra 1041-1 nuk ishte e parcelizuar, këtë e vërteton Përgjigja e ZKK-se në KK., e datës 06.04.2022, ndërsa e protokoluar nga kjo zyrë me nr. 418/05, e datës 06.04.2022, e cila sqaron se ngastra bazë 1041-0 ishte ndarë në 4 nënndarje, të cilat ishin regjistruar, ku ngastra 1041-1 kishte 7664 m². Parcelizimi, kishte ndodhë me fletëparaqitjen për parcelizim nr.117/2009, e paraqitur me datë 15.12.2009, me numrin rendor të librit 88, me nr. protokollit 106/09. Ndarjen e arsyeton edhe certifikata e pronës nr.154/2023, e datës 26.01.2024, nga e cila shihet se ngastra 1041, ishte ndarë në 4 nënndarje.

Nisur nga një gjendje e tillë e fakteve të vërtetuara, nga pretendimet e palëve ndërgjyqëse, sidomos të palës paditëse, pastaj nga provat materiale të deponuara në lëndë e të administruara, deklaratat e palëve, dëshmitë e dëshmitarëve, vrojtimit të drejtpërdrejt të vendngjarjes, gjykata vlerëson se paditësi në pajtim me dispozitat e nenit 20.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronëso-ro-Juridike bazë i cili ka qenë në fuqi në kohën e lidhjes së Kontratës për shitblerjen e paluajtshmërisë e cila është lidhur me datë 28.07.2008 dhe në pajtim me dispozitat e nenit 36 të LPDTS-së, i cili është ligj i zbatueshëm në kohën e lidhjes së Kontratës për shitblerjen e paluajtshmërisë me datë 18.06.2010 dhe kontratës me datë 01.08.2012, e ka fituar bashkëpronësinë në paluajtshmërinë, respektivisht në ngastrën nr.1041-1 me 7664 m², ZK KK.. Ndërsa, në pajtim me nenen 56 të LPDS, paditësi bashkëpronësinë e blerë nga paraardhësit e të paditurve, e ka zgjidhur duke e ndarë fizikisht, duke e fituar të drejtën e pronësisë individuale

dhe ekskluzive me pjesë alikuote të pronës 1/1, të disponueshme në paluajtshmërinë kontestuese, respektivisht ngastrën nr.1041-1 me 7664 m², ZK KK..

Mbi këto baza paditësi ka hy në posedim dhe shfrytëzim të kësaj ngastre si në dispozitivin I. të këtij aktgjykimi, pa u penguar asnjëherë nga të paditurit. Siç kemi thënë disa herë e këtë e ka vërtetuar edhe eksperti gjeodet, se në vendngjarje gjykata kishte vërejtur dhe konstatuar se vija ndarëse mes ngastrave nr.1041-1 dhe 1041-2, edhe pse nuk vërehej dukshëm, për shkak se ato ishin me kulturën e barit, por në afërsi të rrugës së asfaltuar KK.-V., respektivisht në pjesën juglindore në kufi të këtyre dy ngastrave, gjendej një dru në formë hunji, i ngulitur në tokë, të cilin e kishte ngulitur paditësi E.Z. para 5-6 viteve, në prezencën e V., M., P.M.s, N.S.it e T.X.s. Gjithashtu në anën perëndimore në mes të ngastrave 1041-1 dhe 1041-2, ishte mbjell një pemë e llojit kajsii dhe një guri i vogël, e sipas ekspertit gjeodet ky gur vërtetonte vijën kufitare mes ngastrave 1041-1 dhe 1041-2.

Eksperti gjeodet në ekspertizën e datës 31.10.2014, në fund të saj kishte shënuar se nga matjet dhe piketimet e ngastrave kadastrale nr.1041-1 dhe 1041-2, kishte rezultuar se pikat e caktuara ishin të shënjuara në terren me rastin e ndarjes fizike të tyre.

Gjykata ripërsëritë dhe sqaron se paluajtshmëria nga bashkëpronësia e cila ju është nënshtruar ndarjes – pjestimit në këtë çështje konkrete është ngastra kadastrale nr.1041-1, me sipërfaqe prej 7664 m², në zonën kadastrale KK., ku pronar ekskluziv dhe i vetëm i saj vërtetohet se është paditësi E.Z. me përmasa dhe përkufizimet sikur në ekspertizën gjeodete të datës 28.06.2022. Ndërsa në ngastrat respektivisht në nënndarjet tjera si ngastra me nr.1041-2, nr.1041-3 dhe nr.1041-3, paditësi nuk pretendon të drejtën në bashkëpronësi, as ndarjen-pjestimin e tyre, do të thotë se këto 3 nënndarje mbeten në bashkëpronësi të paditurve.

Andaj, gjykata shuarjen e bashkëpronësisë përmes ndarjes, e vlerëson të jetë bërë më herët nga bashkëpronarët, pasi që bashkëpronarët shitës të sipërfaqës së ngastrës 1041-1 prej 7664 m², e kishin marr përsipër dhe kanë disponuar me sendin-paluajtshmërinë e ndarë në bashkëpronësi, të cilën ia kishin shitur dhe dorëzuar blerësit në përmasa dhe përkufizime, siç e shfrytëzon tani

paditësi prej bartjes së kësaj sipërfaqe përmes kontratave mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, siç përcaktohet me nenin 56 të Ligjit për Pronësi dhe të Drejtat tjera Sendore.

Ngastrat-paluajtshmëria tjetër me nr.426-0, nr.436-0, nr.1181-0, nr.1221-0, nr.1739-0 dhe 1740-0, të gjitha ZK KK. nuk kanë qenë objekt ndarje, as objekt shqyrtimi, andaj paditësi mbetet bashkëpronarë në secilën prej tyre me 30240/45360 në pjesët ideale të këtyre ngastrave, siç vërteton edhe certifikata e pronës e datës 09.02.2024.

Gjykata ka vendosur ta lë në fuqi Aktvendimin C.nr.19/13, me datë 30.01.2013, me të cilin ishte caktuar masa e përkohshme sigurorese për ngastrën nr.1041-1 me 7664 m² ZK KK., deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi, pasi që konsiderojmë se këto masa edhe më tej, janë në pajtueshmëri me nenin 297.1 shkronja a) dhe b), të LPK-së, ndërsa masa e përkohshme sigurorese për ngastrat kadastrale nr.426-0, nr.436-0, nr.1181-0, nr.1221-0, nr.1739-0 dhe 1740-0, të gjitha në ZK KK., është në fuqi deri në nxjerjen e ndonjë vendimi tjetër.

Gjykata vendosi si në dispozitivin III. të aktgjykimit duke u mbështetur në nenin 449 lidhur me nenin 452.1 dhe 463.1 të LPK-së, pasi të paditurit e kanë humbur kontestin dhe për këtë arsye u detyruan të paguajnë shpenzimet e paditësit edhe atë, 208 € për përpilimin e padisë, 4,860 € për përfaqësim të avokatit të paditësit për 6 seanca gjyqësore, secilën nga 810 € dhe 170 € për dy ekspertiza të ekspertit gjeodet njëra 100 €, ndërsa tjetra prej 70 €, apo gjithsej 5,238 euro.

Ndërsa, ka refuzuar shpenzimet e kërkuara dhe atë: 208 € për parashtrësën e precizimit të kërkesëpadisë (pasi precizimi është pjesë përbërse e padisë), 810 € për përfaqësimin e avokatit për një seancë (pasi ka mbajtur vetëm 6 përfaqësime jo 7), 210 € për shpenzime të udhëtimit për avokatin në relacionin Prishtinë-V. dhe anasjelltas (kërkesë e pa bazë), 80 € për shpërblimin e ekspertizave (ka paguar vetëm 170 € jo 250 €) dhe 550 € për fjalën përfundimtare të avokatit (kërkesë e pa bazë ligjore), apo gjithsej ka refuzuar 1,858 euro.

Gjykata ka vendosur të zbatoj udhëzimet e Gjykatës së Apelit, të paraqitura përmes Aktvendimit Ac.nr.3529/15, datë 27.05.2020, duke vendosur si në pjesën urdhëruese të këtij aktgjykimi.

Andaj, gjykata duke u bazuar në gjitha këto prova dhe fakte të pakontestueshme, duke qenë e pavarur në vendosje miratoi në tërësi kërkesëpadinë e paditësit.

GJYKATA THEMELORE NË G. – DEGA NË V.
C.nr.863/2020
Më.16.05.2024

G j y q t a r i
Raif Fazliu

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i adresohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2020:110967
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05728748